



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01. Nr.16- 26679/14
Kaçanik, 10.09.2014

Mbështetur në nenit 40.2 (b.) lidhur me nenin 17 të Ligjit nr.03/L-040 – Për Vetëqeverisjen Lokale, të neneve 20.8, 22 dhe 25 të Ligjit Nr.03/L-048 – Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të Ligjit nr.03/L-221. – Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-048 – Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit, të nenit 13 dhe 14 të Ligjit nr.(2013/04-L-233).- Për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2014, të pikës 5 të Vendimit Për Buxhetin e Komunës së Kaçanikut për vitin fiskal 2014 dhe vlerësimet për vitet 2015-2016, të neneve 6.2, 34.5 dhe 61.1 të Statutit të komunës, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e mbajtur me datë 10.09.2014, mori këtë:

V E N D I M
PËR RIALOKIMIN DHE TRANSFERIN E MJETEVE TË PROJEKTEVE KAPITALE SIPAS
BXHETIT TË VITIT 2014

1. Me këtë Vendim Buxheti i Komunës së Kaçanikut për vitin 2014, pas transfereve dhe rialokimeve të investimeve kapitale brenda programeve dhe nën-programeve buxhetore ,duke pas për bazë kërkesat për shfrytëzim sa më racional të mjeteve buxhetore, ngelë në shumën totale i pandryshuar.

2. Te Zyra e Kryetarit buxheti do të zvoglohet për 40,000.00 € te Shpenzimet Kapitale dhe ate duke e anuluar Projektin me kod 88626: "Asfaltimi i rrugës në lagjen e Burrnikëve në fshatin Runjevë" dhe kjo shumë të transferohet te programi buxhetor i Shërbimeve Publike, Mbrojtjes Civile dhe Emergjencave – nënprogrami Infrastruktura Rrugore te projekti me kod 88641- "Rregullimi i Kanalizimeve Fekale dhe Atmosferike".

3. Te Shërbimet Publike,Mbrojtja Civile dhe Emergjenca, projekti kapital me kod 90399 "Ndertimi i sistemit te ujësjellësit në fshatin Gllloboqicë – faza e II-të në shumë prej 50,000.00 €, në tëresi do të rialokohet mbrenda të njejtit program-nënprogram buxhetor duke krijuar projekt të ri në tabelen 4.2 me emërtimin: "Ndertimi dhe Rregullimi i Ujësjellësit për qytetin e Kaçanikut".

4. Ky transfer dhe rialokim ne keto dy projekte kapitale te cekura ne pikat 2 dhe 3 të këtij vendimi, është shkoqitur nga vendimi i miratuar ne Kuvendin e Komunes me nr. 01/05-400-20754/2014 të datës 18.07.2014 mbi Rishikimin gjashtëmujorë te Buxhetit të vitit 2014, dhe këto projekte më nuk do të jenë pjesë e rishikimit gjashtëmujorë të vitit 2014.

5. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi janë vetëm ndyshimet e bëra në Tabelën 4.1 dhe Tabelën 4.2 të Buxhetit të vitit 2014.

6. Për realizimin e këtij Vendimi, obligohet Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit, e cila drejtori të njejtin vendim do ta zbaton në Ministrinë e Financave, respektivisht në Departamentin e Buxhetit dhe Departamentin e Thesarit.

7. Ky Vendim hyn në fuqi nga dita e aprovimit dhe do të vlejë për deri sa nuk merret ndonjë vendim tjetër.

Me këtë Vendim njoftohen:

1. Kryetari i Komunës,
2. Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim (nëpërmjet kësaj drejtorie njoftohen organet tjera relevante) dhe
3. Arkiva.

Kryesuesi i Kuvendit,
Xhelal Gashi

